

VENDIM
Nr. 856 , datë 4.12.2003

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 370, DATË 15.9.1997 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR HAPJEN E MISIONIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË
SELISË SË NATO-S"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2 të vendimit nr.370, datë 15.9.1997 të Këshillit të Ministrave shtohet paragrafi, si më poshtë vijon:

"Në këtë mision funksionon përfaqësia ushtarake.

Kjo përfaqësi përbëhet nga:

- Përfaqësuesi ushtarak i misionit në Nato	oficer	gjeneral-brigade;
- Zëvendëspërfaqësuesi ushtarak i misionit në Nato	oficer	kolonel;
- Oficer shtabioficer	nënkolonel;	
Specialist/ Koordinues	oficer	major;
- Nënoficer i administrimit/sekretar	nënoficer	k/kapter."

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano